

## Për herë të parë një anëtar i Diasporës, pjesë e një institucioni publik në Shqipëri



Për herë të parë një anëtar i Diasporës shqiptare do të jetë pjesë e një institucioni publik në Shqipëri. Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, për emërimin e zjy. Anila Hyka Smorgravi, si anëtare të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ajo do të jetë pjesë e këtij këshilli si përfaqësuese nga Këshilli Koordinues i Diasporës. Këshilli i Ministrave miratoi gjithashtu edhe anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës duke plotësuar kështu numrin e plotë të anëtarëve të këtij këshilli sipas vendimit "Dise ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.594, datë 09.10.2018, të Këshillit të Ministrave "Për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës". Për pjesën e mbetur të mandatit, emërohen anëtar të Këshillit Drejtues: Zjy. Fjoralba Caka emërohet në vend të Zjy. Teuta Voda; si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për drejtësinë: Z. Kostandin Shkurti emërohet në vend të Zjy. Besa Shahini, si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin si dhe zjy. Kozeta Angjeliu e cila emërohet në vend të Zjy. Miroca Hysa Çulqi, si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për kulturën.



## Agjencia Kombëtare e Diasporës marrëveshje me TKOB



Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës zjy. Elveta Kondi firmosi sot marrëveshjen e bashkëpunimit me Drejtoreshën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit zjy. Zana Çela me qëllim ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në Diasporë. Zjy. Kondi u shpreh se ky bashkëpunim do të jetë shumë frytdhënës pasi komuniteti shqiptar në Diasporë ndër vite ka ruajtur vlerat tona kombëtare, duke i përcjell ato nga një brez në tjetrin. Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me trupën e Ansambilit Kombëtar do të realizojnë në komunitete të ndryshme shqiptare në Diasporë disa seminare për njihjen e këngëve dhe valleve tradicionale shqiptare. Qëllimi i këtyre seminareve që do të fillojnë brenda muajit qershor do të jetë afrimi i të rinjve shqiptarë në Diasporë me kulturën e vendit të origjinës. Kjo marrëveshje parashikon organizimin e kurseve dhe trajnimeve për mësimin e valleve popullore, këngëve folklorike shqiptare nga Ansambli Shtetëror, zhvillimin e aktiviteteve me fokus ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Diasporë si dhe organizimin e ekskursioneve dhe vizitave studentore të komunitetit shqiptar.

Në Vatikan me përfaqësues të komunitetit arbëresh të Eparkisë së Ungros, në audiencën e veçantë të mbajtur nga Papa Françesku.



## Papa Françesku audiencë të veçantë për komunitetin arbëresh në 100 vjetorin e Eparkisë së Ungros



Papa Françesku mbajti në Vatikan një audiencë të veçantë me rastin e 100 vjetorit të themelimit të Eparkisë së Ungros. Në këtë ngjarje të rëndësishme për komunitetin arbëresh ishte i pranishëm edhe ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, ambasadorja e Shqipërisë në Romë zjy. Anila Bitri Lani si dhe kandidatët italiano-shqiptarë të zgjedhjeve lokale dhe evropiane. Në fjalën e tij Papa i cilësoi arbëreshët si dëshmitarë të vërtetë të vllazërisë mes popujve. Ky përvjetor i rëndësishëm mboldhi në Vatikan 6 mijë pjesëmarrës.

## FSHZHD mori pjesë në Konferencën Ekonomike të Diasporës Shqiptare nga Europa



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mori pjesë më 24 dhe 25 maj në Konferencën Ekonomike të Diasporës Shqiptare nga Europa - B2B, organizuar nga Rrjeti i Biznesit Shqiptar të Diasporës nga Evropa në Prishtinë. Konferenca kishte për qëllim lidhjen e bizneseve të Diasporës nga Evropa me bizneset e Kosovës dhe identifikimin e mundësive për investime. Gjatë takimeve B2B, kompanitë pjesëmarrëse patën mundësi të krijojnë partneritete dhe marrëveshje të reja për rrjetin e eksporteve dhe zhvillimin e sipërmarrjes në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë event Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, pati mundësinë të kontaktohej me shumë biznese të Diasporës, në kuadër të partneriteteve të përbashkëta, për rrjetëzimin edhe me bizneset shqiptare në Shqipëri dhe në Diasporë.

## Anëtari i KKD-së Sokrat Sinaj argumenton potencialin e madh që ka Diaspora shqiptare



Çfarë mund t'i sjellë Diaspora viseve shqiptare në Ballkan? Përtëj samiteve duhet të mendohet për transferim të dijes, përvojës potencialit dhe kapitalit. Kjo duhet të jetë një ndër detyrat parësore të Këshillit Koordinues të Diasporës të themeluar së fundi në Tiranë. Diaspora është më shumë se folklor, antropologji, histori dhe kujtim. Ajo mund të jetë një shtyllë e rëndësishme për zhvillimin e atdheut dhe një urë lidhëse me përfitim të dyanshëm...

## Arba Kokalari, eurodeputetja e pare shqiptare



Arba Kokalari, e cila jeton në Stokholm të Suedisë, është shqiptarja e parë që siguron një vend në Parlamentin Europian. Politikania e re është pjesë e partisë së moderuar, e cila fitoi 17.6 për qind të votave, duke marrë kështu 4 eurodeputetë, mes të cilëve edhe Kokalari. E lindur në Tiranë, 27 nëntorin e vitit 1986, ajo ka mbajtur postin e sekretares ndërkombëtare të grupimit rinor të partisë në të cilën aderon, e ku ka qenë mjaft aktive.